



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**



Foto: Operatorët turistikë japonezë duke zbuluar vende për pakot e tyre turistike.

Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat

PPSE - Kosovë

Raport vjetor për vitin 2018

16 Nëntor 2017 – 31 Dhjetor 2018

Prishtinë

Në bashkëpunim me:



Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	3
1. Informatat themelore	4
2. Përmbledhja ekzekutive.....	6
3. Raportimi i rezultateve për të arriturat	7
3.1 Ndikimi	7
3.2 Rezultati 1: Konkurrueshmëria e sektorëve të përzgjedhur	8
3.3 Rezultati 2: NVM-të përmirësojnë ofertën, eficientë dhe konkurrueshmërinë e tyre në sisteme gjithëpërfshirës të tregut të cilat janë të përmirësuara dhe më të organizuara	13
3.4.1. Fondi i mundësive	19
3.4.2. Fondi për Përfshirjen Sociale	20
4. Temat transversale	21
4.1. Përfshirja Sociale.....	21
4.2. Gjinia	21
5. Konsulenca	22
6. Financat.....	Error! Bookmark not defined.
6.1. Buxheti	Error! Bookmark not defined.
7. Organizimi i projektit, menaxhimi dhe drejtimi.....	Error! Bookmark not defined.
7.1. Ngritja e kapaciteteve dhe shkëmbimet.....	Error! Bookmark not defined.
7.2. Organizimi dhe menaxhimi i projektit	Error! Bookmark not defined.
7.2.1. Drejtimi i projektit.....	22
7.2.2. Monitorimi dhe matja e rezultateve.....	23
7.3 Komunikimi	24
8. Mësimet e nxjerra.....	25

Lista e shkurtesave

BEAM	Ndërtimi i tregjeve efektive dhe të qasshme
BMO	Organizatë e anëtarësimit të biznesit
CHF	Franga zvicerane
DCED	Komiteti i donatorëve për zhvillimin e ndërmarrjeve
DMO	Organizatë për menaxhimin e destinacionit
ENE	Ekonomia dhe punësimi
EYE	Rritja e punësimit të të rinjve
FAMtrip	Udhëtime të familjarizimit
FGD	Diskutim në grupe të fokusuara
FTE	Punësim me orar të plotë
FNI	Ushqimi dhe përbërësit natyral
GAP	Praktikat e mira bujqësore
HO	Zyra qendrore
KIESA	Agjencia Kosovare e Investimeve dhe Përkrahjes së Ndërmarrjeve
KMC	Klubi i Prodhuesve të Kosovës
MAP	Bimët medicinale aromatike
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPJ	Ministra e Punëve të Jashtme
MRM	Monitorimi dhe matja e rezultateve
MSD	Zhvillimi i sistemit të tregut
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
OC	Rezultat
OF	Fondi i mundësive
PPSE	Promovimi i punësimit në sektorin privat
RAE	Romë, Ashkali and Egjiptian
SC	Komitet drejtues
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SEC	Trupat e ekspertëve seniorë
SGDM	Metodologjia e Saint Gallen-it për menaxhimin e destinacioneve
SHKF	Shoqata e prodhuesve të frutave
SHTIB	Shoqatë e shitësve të lëndës së parë

SIF	Fondi për përfshirjen sociale
SME	Ndërmarrje e vogël dhe e mesme
SRP	Paneli për shqyrtimin strategjik
ToR	Termet e referencës
YPO	Plani vjetor i veprimit

1. Informatat themelore

Shteti: Kosovë	Emri i projektit: Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSE)
SDC No SAP:	
Fusha e strategjisë së bashkëpunimit: ENE	

Synimi	NVM-të që veprojnë në sektorët ekonomikë të mirë-organizuar dhe përfshirës, që sigurojnë rritje të punësimit të qëndrueshëm për gratë dhe burrat e rinj në Kosovë.
Rezultatet (OC)	<p>Rezultati 1: NVM-të e sektorëve të përzgjedhur rrisin produktivitetin e tyre dhe gjenerojnë të ardhura shtesë dhe punësim.</p> <p>Rezultati 2: NVM-të përmirësojnë ofertën, efikasitetin dhe konkurrueshmërinë e tyre në sisteme gjithëpërfshirës të tregut të cilat janë të përmirësuara dhe më të organizuara.</p>

Kohëzgjatja e fazës së projektit: 16.11.2017-15.11.2021	Periudha e raportimit: 16.11.2017-31.12.2018
--	---

Buxheti në këtë fazë (CHF) 7,276,126,50	Buxheti nga 16.11.2017 deri më 31.12. 2018 (CHF) – 2,126,200
Buxheti i shpenzuar në këtë fazë (CHF) 2,127,377	

Informacion mbi kontributet e partnerëve dhe/ose donatorëve të tjerë (llogaritur në CHF) 100% SDC
--

Organizatat zbatuese:	Swisscontact-i dhe Instituti Riinvest
Partnerët kryesorë kombëtarë: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Odat Ekonomike, firmat kryesore	Partnerët kryesorë ndërkombëtarë: n/a

Koordinatorë e projektit Argjentina Grazhdani	Numri i stafit të projektit Kombëtar: 16
---	--

Konsulentët kombëtarë (ditët e planifikuara): ¹ 9	Ditët e konsulencës në kuadër të buxhetit të intervenimeve:	139.5
Konsulentët kombëtarë (ditët e planifikuara): 41	Kombëtar:	93
Riinvest (ditët e planifikuara): 57	Ndërkombëtar:	46.5
Swisscontact (ditët e planifikuara): 57	Riinvest (ditët e ekzekutuara):	57

¹ Konsulenca të tjera ndërkombëtare dhe lokale janë planifikuar përmes buxhetit të pjesës 4 lidhur me vlerësimet dhe intervenimet tek tre rezultatet e PPSE-së (Shih shtojcën III).

2. Përmbledhja ekzekutive

Gjatë vitit të parë të fazës së II-të PPSE-së, intervenimet e mbështetura dhe të zbatuara ishin përqendruar në shkallën dhe potencialin e zgjerimit. Rezultatet e arritshme për vitin e parë të zbatimit kanë përmbushur dhe tejkaluar (në disa tregues) objektivat e punësimit të PPSE-së për vitin e parë. Gjithsesi, ndërhyrjet e mbështetura kanë gjeneruar rreth 475 FTE shtesë (së këndejmi FTE; Punësim me orar të plotë, ang. Full time employment), me mbi 1,700 gra dhe burra që kanë përfituar mbi 1.75 milionë franga zvicerane nga mundësitë e punës. Rezultatet në lidhje me shtrirjen dhe shumën e të ardhurave të krijuara nga përfitimi i NVM-ve (së këndejmi NVM - Ndërmarrje të vogla dhe të mesme, ang. Small and medium enterprises) kanë qenë pozitive, por me një shkallë më të ulët. Kjo, logjikisht është për shkak të vonesës kohore që kërkohet për shërbime të reja mbështetëse dhe ndryshime në nivelin e NVM-ve. Rreth 106 NVM kanë përfituar nga ndërhyrjet e PPSE-së, duke regjistruar të ardhura shtesë neto prej mbi 570,000 franga zvicerane.

Në kuadër të sektorit të FNI-së (së këndejmi FNI; Ushqimi dhe përbërësit natyral, ang. Food and natural ingredients), janë bërë përpjekje të madhe për intervenimet në lidhje me bujqësinë e kontraktuar, lehtësimin e tregtisë dhe zhvillimin e produkteve. Bujqësia e kontraktuar dhe intervenimet për lehtësimin e tregtisë kanë prodhuar një pjesë të konsiderueshme të rezultateve të arritshme nga PPSE-ja. PPSE ka mbështetur bujqësinë e kontraktuar në 6 rajone të reja me 9 partnerë me një shtrirje prej 335 fermerësh. Si rezultat i mbështetjes për lehtësimin të tregut, NVM-të e Kosovës kanë pasur mundësi të hyjnë në tregjet e reja të eksportit, të nënshkruajnë kontrata afatgjata ndërkombëtare dhe të arrijnë eksportet shtesë prej pothuajse 900,000 franga zvicerane. PPSE ka mbështetur rreth 17 NVM për të përmirësuar produktet e tyre ekzistuese dhe për të lansuar produkte të reja, duke rezultuar në mbi 22 produkte të reja përfundimtare në treg, ndërsa të tjerat do të prezantohen në treg së shpejti.

Në vitin 2018, PPSE-ja ka mbështetur sektorin e turizmit me aktivitete rreth tërheqjes së turistëve ndërkombëtarë, me zhvillimin e produkteve të reja turistike, trajnimin për profesionet e kërkuara të turizmit dhe mikpritjes dhe mbështetjen e Komunës së Prishtinës dhe Komunës së Prizrenit për të përmirësuar ofertën e tyre turistike dhe aktivitetet e koordinimit të sektorit. Fondi i Mundësive (së këndejmi OP; Fondi i mundësive, ang. Opportunity fund) është integruar më tej brenda intervenimeve në sektor, duke mbështetur projekte të bashkë-investimit me qëllim të promovimit të rritjes së qëndrueshme dhe të zinxhirit të vlerës. Fondi për Përfshirje Sociale është një mekanizëm i ri për PPSE-në, i prezantuar në fazën e II-të, për të promovuar barazinë dhe përfshirjen e grave dhe komuniteteve pakicë të përjashtuara nga shoqëria.

3. Raportimi i rezultateve për të arriturat

3.1 Ndikimi

NDIKIMI: NVM-të që operojnë në sektorë ekonomikë të mirëorganizuar dhe përfshirës, sigurojnë një rritje të punësimit fitimprurës dhe të qëndrueshëm për gratë dhe burrat e rinj në Kosovë	Treguesi i ndikimit	Vlerësimi bazë ² 2017	2018 ³ (T=Targeti, A=të arriturat)	Përqindja (%) graduale e arritur në vitin 2018	Fundi i fazës 2021	% komulative e arritur në këtë fazë
	Ndikimi: FTE të punësimit shtesë neto	850 FTEs	T= 500 FTEs A= 475 FTEs	95%	2,000 FTEs	24%
	Punësimi shtesë neto (gratë) FTEs	270 FTEs	T= 150 FTEs A=188 FTEs	125%	600 FTEs	31%
	Punësimi shtesë neto (minorite tet) FTEs	75 FTEs	T= 50 FTEs A=72 FTEs	144%	150 FTEs	36%

Ndërhyrjet e PPSE-së në vitin 2018 kanë prodhuar rreth 475 punësime me orar të plotë. Intervenimet në sektorin e FNI-së kontribuojnë në gati 75% të këtij rezultati krahasuar me 19% të sektorit të turizmit dhe 6% nga intervenimet e tjera (riciklimi) përmes SIF-it. Rezultatet e paraqitura në raport janë validuar nëpërmjet vlerësimeve të ndikimit dhe intervistave të drejtpërdrejta me partnerët përfitues. Rezultatet e gjeneruara në vitin raportues konfirmojnë se PPSE ka arritur objektivat e saj vjetor.

Intervenimet kryesore në sektorin e FNI-së për vitin 2018 kanë qenë: **'Fuqizimi i sistemit të bujqësisë kontraktuese'**; **'Mbështetja e lidhjeve tregtare'**; **'Shërbimet e përmirësuara të informacionit'**; **'Prezantimi i prodhuesve të specializuar të fidanëve'**; **'Trajnim për rritje'**; dhe **'Lehtësimi i programeve të certifikimit'**. Ekipi ka kryer vlerësime të ndikimit për të gjitha intervenimet. Në tërësi, ndërhyrjet e FNI-së kanë gjeneruar rreth **357 FTE** shtesë në vitin 2018, ku **45%** ishin të përfaqësuara nga **gjinia femërore** dhe **9% nga pakicat**. Pjesa më e madhe e punësimit është gjeneruar në nivelin e prodhimit primar. Kjo është mundësuar duke rritur kërkesën (si eksportet ashtu edhe kërkesën vendore) dhe kapacitetet e përpunuesve të partnerëve, qendrave të grumbullimit dhe eksportuesve, si dhe duke tërhequr fermerë të rinj dhe duke rritur prodhimin primar.

Në sektorin e FNI-së, me rritjen e kërkesës për perime dhe produktet e bimëve medicinale aromatike (së këndejmë MAP; Bimë medicinale aromatike, ang. Medicinal aromatic plants) si në nivel lokal ashtu dhe atë ndërkombëtar, kjo ka krijuar një mundësi për zgjerimin e bujqësisë së kontraktuar. Nga ana tjetër, disa NVM kanë filluar të rriten, duke bërë kontrata lokale dhe kontrata për eksport, në këtë mënyrë duke krijuar një domosdoshmëri për sigurimin e prodhimit primar. Bujqësia e kontraktuar sjellë një

² Bazuar në arritjet e fazës së I-rë.

³ Kolona paraqet rezultatet e matura brenda raportit të raportimit.

element të sigurisë së tregut për fermerët. Kjo i ka motivuar fermerët që të zgjerojnë prodhimin e bujqësisë dhe të plotësojnë nevojat për prodhim të kontraktuar. Përderisa kjo kërkesë vazhdon të rritet, sfida kryesore në prodhimin bujqësor do të jetë mungesa e fuqisë punëtore.

Në vitin 2018, sektori i turizmit është fokusuar në zbatimin e intervenimeve të mëposhtme: '**Zhvillimi i produkteve të turizmit**'; '**Atraksionet Turistike**'; '**Profesionet e specializuara të turizmit**'; '**Promovimi ndërkombëtar** dhe tema rreth **koordinimit të sektorit**. Këto intervenime kanë gjeneruar **92 FTE shtesë**, me **28% femra** dhe **16% përfaqësim të pakicave**. Trendet e turizmit në vend tregojnë se numri i bizneseve të turizmit është në rritje, duke rezultuar në më shumë njësi akomodimi, restorante, operatorë turistikë dhe udhëzues/guida. Rezultatet nga anketat e ofertës së turizmit dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës tregojnë trendë në rritje në punësim dhe restorante (mbi 10%) gjatë tre viteve të fundit. Në të njëjtën kohë, më shumë iniciativa dhe angazhime janë vënë re nga sektori privat, OJQ-të dhe sektori publik.

Për shkak të aktiviteteve të promovimit ndërkombëtar, numri i turistëve të cilët vizitojnë Kosovën është duke u rritur ndjeshëm. Kjo përkthehet në kërkesën për më shumë akomodim, ushqim, transport, profesione të reja, aktivitete dhe atraksione turistike. Sipas të dhënave zyrtare, sektori i mikpritjes ka shënuar rritje prej së paku 8% në vitin 2018.

3.2 Rezultati 1: Konkurrueshmëria e sektorëve të përzgjedhur

Rezultati 1: Të rinjtë, gratë dhe minoritetet përfitojnë nga punësimi fitimprurës dhe gjithëpërfshirës, i krijuar në NVM-të dinamike në sektorët në rritje	Treguesi i rezultatit	Vlerësimi bazë 2017	2018 (T=Targeti, A=të arriturat)	Përqindja (%) graduale e arritur në vitin 2018	Fundi i fazës 2021	% komulative e arritur në këtë fazë
	OC 1.1 Numri i grave dhe burrave të punësuar me paga	0	T= 1,250 A= 1,730	138%	5,000	35%
	Numri i grave dhe burrave të punësuar me paga (gratë)	0	T= 375 A=674	180%	1,500	45%
	Numri i grave dhe burrave të punësuar me paga (minoritetet)	0	T= 125 A=130	104%	500	26%
	OC 1.2 Rritja e të ardhurave për 5,000 gra dhe burra përmes pagës/të hyrave	0	T= CHF 2,400,000 A=CHF 1,756,016	73%	CHF 9,600,000	18%

Në vitin 2018, PPSE ka atribuar punësimin e **1,580 grave dhe burrave** me pagë si rezultat i intervenimeve të **FNI-së**. Struktura gjinore e këtyre punonjësve është **42% femra** dhe **58% meshkuj**,

ndërsa përfaqësimi i **minoriteteve** është 6%. **Fitimet** (përmes pagave ose të hyrave) të burrave dhe grave të angazhuar shtesë në vitin 2018 arrin në **1,141,357 €**.⁴

Intervenimet në sektorin e **turizmit** kanë krijuar **mundësi punësimi** për rreth **125 gra dhe burra**, me një strukturë gjinore prej **76% meshkuj** dhe **24% femra**, dhe një përfaqësim të pakicave prej **13%**. Të ardhurat e përgjithshme të personave që mund të atribuohen si të punësuar rishtazi arrin në **312,000 €**. Ekipi ka vënë re se bizneset e turizmit po rriten vazhdimisht, çdo vit është rritur numri i udhëzuesve/guidave, për shkak të të ardhurave më të larta dhe qarkullimit të turistëve që mund t'i atribuohen intervenimeve të PPSE-së. Detajet e intervenimeve dhe aktiviteteve që do të çojnë në rezultate janë paraqitur në detaje në rezultatet përkatëse.

Rezultati 1.1 NVM-të kanë përmirësuar cilësinë dhe shumëllojshmërinë e produkteve dhe shërbimeve.

Rezultati 1.1 NVM-të kanë përmirësuar cilësinë dhe shumëllojshmërinë e produkteve dhe shërbimeve.	Treguesi i rezultatit	Vlerësimi bazë 2017	2018 (T=Targeti, A=të arriturat)	Përqindja (%) graduale e arritur në vitin 2018	Fundi i fazës 2021	% komulative e arritur në këtë fazë
	OP 1.1.1 Numri i produkteve dhe shërbimeve të reja dhe të përmirësuara të promovuara përmes NVM-ve	0	T= 38 A=35	92%	150	23%
	OP 1.1.2 Vlera shtesë e investimeve për produktet dhe shërbimet e reja	0	T= CHF 1,250,000 A=CHF 1,047,256	84%	CHF 5,000,000	21%
	OP 1.1.3 Numri i NVM-ve që ofrojnë produkte dhe shërbime të reja dhe të përmirësuara	0	T= 25 A=16	64%	100	16%

PPSE ka mbështetur NVM-të në **sektorin e FNI-së** për të përmirësuar cilësinë dhe shumëllojshmërinë e produkteve finale nëpërmjet intervenimeve të saj dhe të OF-së. Kjo mbështetje është lehtësuar nëpërmjet mekanizmave të tillë si: platforma e biznesit 'Trajnim për rritje'- lehtësuar nga CEED, bashkë-investim në kapacitetet përpunuese në katër NVM-ve përmes OF-së dhe intervenimeve, dhe mbështetje individuale të konsulencës për NVM-të, përmes misionëve të SEC-ut (SEC; Trupat e ekspertëve seniorë, ang. Senior experts corps) dhe Recura.

Në kuadër të ndërhyrjeve të FNI-së, rreth **14 NVM** të mbështetura nga PPSE-ja kanë futur në treg **22 produkte e përpunuara përfundimtare**⁵ dhe **11 produkte primare**⁶. PPSE ka mbështetur mbi 30 NVM

⁴ Kjo shumë përfshin fitimet përmes pagave dhe të hyrave, si dhe të ardhurat neto të fermave familjare. Anëtarët e fermave familjare nuk paguhen me paga apo të hyra, prandaj të ardhurat e fermave familjare konsiderohen si të ardhura të anëtarëve të familjes të përfshirë në bujqësi.

⁵ Produktet e përpunuara përfundimtare përfshijnë shembuj të tillë si erëza, gjalpë me kikirika/ lajthi/ farëra luledielli / mermelate goji berry (manaferra goji), supa, çajëra, ëmbëlsira etj.

për përmirësimin dhe futjen e produkteve dhe shërbimeve të reja për sektorin e FNI-së, shumica e të cilave pritet të lansohen dhe t'i përmirësojnë produktet e tyre në vitin 2019. Për vitin 2018, partnerët e NVM-ve kanë raportuar investime shtesë të atribuueshme të cilat kapin shumën prej gati **850,000 €**.

- Intervenimi '**Trajnimi për rritje**' është zbatuar nga një ofrues lokal i shërbimeve të specializuara - CEED me qëllim të mbështetjes së NVM-ve për përmirësimin e cilësisë së produkteve ekzistuese dhe futjen e produkteve të reja. Aktivitetet e këtij intervenimi përfshijnë shkëmbimin e njohurive, vizitat studimore dhe trajnimet individuale në shtëpi. '**Trajnimi për rritje**' është krijuar si një platformë biznesi, ku 17 NVM janë regjistruar përmes pagesës së një tarife shërbimi (zbritur përmes mbështetjes së PPSE-së). NVM-të janë ftuar përmes një grumbulli më të madh, ku përzgjedhja përfundimtare është bërë me prioritet të NVM-ve për futjen e produkteve të reja dhe përmirësimin e produkteve ekzistuese. NVM-të pjesëmarrëse ishin nga sektorët e pemëve dhe perimeve, bimëve medicinale aromatike dhe sektori i konditorisë. NVM-të pjesëmarrëse iu kanë nënshtruar trajnimit në tema të identifikuar për zhvillimin e produkteve, kanë vizituar tre NVM vendore dhe dy rajonale në sektorin e ushqimit. Trajnimi në shtëpi është realizuar tek 9 NVM më të përkushtuara në platformën e biznesit. Vizitat studimore rajonale dhe trajnimet individuale janë vlerësuar lart nga NVM-të. Prandaj, PPSE-ja planifikon të ndjekë platformën e biznesit në këto dy fusha.
- Për të përmirësuar kapacitetet përpunuese, pesë NVM janë mbështetur përmes bashkëfinancimit të makinerive. Këtu përfshihen **dy NVM** (PNK, Peppermint) mbështetur përmes OF-së dhe **dy NVM** (Vicianum dhe 99 Lule) përmes intervenimeve sektoriale. Në të gjitha rastet, përmirësimi i makinerisë u ka mundësuar këtyre NVM-ve të përmirësojnë cilësinë dhe të zgjerojnë kapacitetet prodhuese për produktet finale. Për më tepër, **katër NVM** janë mbështetur përmes misioneve SEC (Missini, Skurt Homemade, Meridian Kitchen dhe Trboljevac) dhe **një NVM** është mbështetur me një konsulencë për rritje me Recura (KB Krusha) për të përmirësuar proceset, produktet dhe shërbimet e tyre. Nga pesë NVM, dy ishin në pronësi të pakicave dhe dy ishin në pronësi të grave.
- PPSE ka hulumtuar bashkëpunimin me ofruesit e shërbimeve ndërkombëtare për organizimin e trajnimeve të shkurtëra për **teknologjinë ushqimore** për NVM-të në industrinë e ushqimit. Ekipi është duke hulumtuar modalitetet e bashkëpunimit me Universitetin e Teknologjisë Ushqimore në Plovdiv, pas pamundësisë për të organizuar këto trajnime nga ana e Qendrës Industriale të Arsimit Profesional Bursa (BUTGEM BTSO). Pjesëmarrësit e trajnimeve të tilla afatshkurtëra do të jenë teknologë të ushqimit në kuadër të NVM-ve në sektorët e bylmetit, frutave dhe perimeve.

Për të mbështetur zhvillimin e produkteve të reja dhe atraksioneve **turistike**, PPSE-ja ka zbatuar dy intervenime '**Zhvillimi i produkteve të turizmit**' dhe '**Atraksionet turistike**'. Në mënyrë të veçantë, projekti ka mbështetur dy akterë të turizmit (Aeroclub Shkaba dhe Supercampers) në prezantimin e katër produkteve të reja turistike. Për më tepër, ekipi ka punuar me Komunën e Prishtinës dhe Komunën e Prizrenit, me nënshkrimin e Memorandumeve të Mirëkuptimit, drejt krijimit të një kuadri ligjor që do të çojë në përmirësimin dhe ngritjen e muzeve lokale dhe përmirësimin e ofertës turistike të qytetit. Sfidat kryesore në periudhën raportuese ishin prezantimi i aktiviteteve të turizmit të PPSE-së në komunat e reja të Prishtinës dhe Prizrenit, përfshirja e të cilave në sektorin e turizmit është ende në fazat fillestare.

⁶ Këto produkte përfshijnë kultura të reja bujqësore të integruara në bujqësinë e kontraktuar siç janë: specat feferona, kornishona, kamomilë, peppermint, rigon, goji berry, golden berry (manaferra të arta), kungull, lulediell dhe hithër.

Produktet e **turizmit** të cilat u mbështetën në vitin 2018 do të lansohen në fillim të vitit 2019. PPSE-ja ka vazhduar të monitorojë NVM-të e turizmit dhe produktet që janë mbështetur gjatë dy viteve të fundit (shirit lëvizës për skijim dhe park argëtues për fëmijë në zonën e Bogës, Komuna e Pejës), të cilat kanë vazhduar të tërheqin turistët, duke çuar kështu në më shumë se 50 biznese përfituese. Në vitin 2018, janë prezantuar **dy produkte të reja turistike** (udhëtime me makinën për shtypjen e borës dhe shenjëtari në Rugovë) nga **dy** partnerë të PPSE-së. Një vlerë prej **64,500€** është **investuar** nga PPSE-ja për t'i mbështetur NVM-të.

- Nëpërmjet intervenimit **'Zhvillimi i produkteve të turizmit'**, PPSE-ja ka mbështetur zhvillimin e katër produkteve turistike. Produkti i parë është paragliding, i zhvilluar në bashkëpunim me Aeroclub Shkaba dhe Komunën e Prizrenit. Të tre produktet e tjera janë kamping luksoz (ang. glamping), çiklizëm dhe kayak, të cilat janë zhvilluar në bashkëpunim me operatorin turistik Supercampers dhe Komunën e Prizrenit. Të gjitha produktet pritet të lansohen në pranverë të vitit 2019. PPSE-ja është duke kërkuar në mënyrë aktive partnerë privatë për të zhvilluar produkte turistike, por iniciativa nga sektori privat mbetet i pakënaqshëm.
- Nëpërmjet intervenimit **'Atraksionet turistike'**, PPSE është duke mbështetur Komunën e Prishtinës me ekspertizë teknike lokale, në aktivitetet që lidhen me themelimin dhe ripërdorimin e objekteve kulturore, planin e menaxhimit të muzeut dhe planin e të ardhurave, qendrën historike të qytetit, galeritë, hartimin e dokumenteve/statuteve ligjore, krijimin e qendrës së informacionit turistik dhe lehtësimin e procesit në hartimin e strategjisë së turizmit. Si rezultat, pritet që Komuna e Prishtinës do të financojë ngritjen e atraksioneve të mëposhtme: Muzeu familjar i shtëpisë së familjes Hertica, Strehim i Arteve, Modeli i rrugës për Qendrën historike të Prishtinës dhe Muzeu 'Ibrahim Kodra'. Muze të reja pritet të operohen nga sektori privat ose OJQ-të.

Të arriturat 1.2: NVM-të kanë rritur prodhimin.

Të arriturat 1.2: NVM-të kanë rritur prodhimin	Treguesi i të arriturave	Vlerësimi bazë 2017	2018 (T=Targeti, A=të arriturat)	Përqindja (%) graduale e arritur në vitin 2018	Fundi i fazës 2021	% komulative e arritur në këtë fazë
	OP 1.2.1 Numri i fermave dhe NVM-ve të përfshira në bujqësi kontraktuese	350 SME	T= 250 SME A= 345 SME	138%	1,000 SME	35%
	OP 1.2.2 Rritja e prodhimit të kontraktuar	200 ha	T= 125 ha A= 401 ha	320%	500 ha	80%

Dy intervenime janë lehtësuar me qëllim të rritjes së sasisë së prodhimit dhe cilësisë së fermerëve për kontraktorët (përpunuesit, qendrat e grumbullimit dhe eksportuesit). Në kuadër të intervenimit **'Fuqizimi i sistemit të bujqësisë së kontraktuar'**, PPSE-ja ka mbështetur kontraktorët (11 NVM) në rritjen e kapaciteteve përpunuese/grumbulluese, si dhe shërbimet (këshillimore dhe makineri) për fermerët e tyre. Kjo ka mundësuar që fermerët ekzistues të rrisin produktivitetin dhe cilësinë, si dhe të tërheqin fermerë të rinj në kontraktim. Për më tepër, PPSE-ja është duke mbështetur intervenimin

'Prezantimi i prodhuesve të specializuar të fidanëve' (2 NVM), me qëllim të përmirësimit të qasjes dhe cilësisë së fidanëve për fermerët (me fokus tek fermerët e kontraktuar).

Në vitin 2018, PPSE ka arritur në total një numër prej **335** fermash përfituese dhe **10 ndërmarrje të vogla dhe të mesme**, nga të cilat 113 janë gra dhe 28 nga pakicat. Fermat të cilat kanë përfituar nga PPSE-ja kanë zgjeruar zonën e prodhimit të kontraktuar me mbi 400 ha në vitin 2018. Është e rëndësishme të përmendet se ky intervenim ka prodhuar shumicën e rezultateve të PPSE-së në aspektin e punësimit. PPSE-ja ka atribuuar mbi **222 FTE** dhe pothuajse **1200 njerëz**, duke përfshirë rezultate të rëndësishme për punësimin e grave (rreth 40%) dhe të pakicave (serb dhe RAE - rreth 10%) që janë angazhuar shtesë (në mesin e fermerëve të rinj⁷) brenda intervenimit për bujqësinë e kontraktuar. Përveç kësaj, fermerët e kontraktuar të mbështetur (gjithashtu të kontraktuar në vitin 2017) kanë krijuar vende pune të qëndrueshme dhe ia kanë atribuuar PPSE-së në kuadër të fazës së I-rë dhe janë përjashtuar nga rezultatet e atribuuara për këtë periudhë raportuese⁸.

- Nëpërmjet intervenimit '**Fuqizimi i sistemit të bujqësisë së kontraktuar**', ekipi i PPSE-së ka bashkëpunuar me 11 kontraktorë (përpunues, qendra grumbullimi dhe eksportues) të cilët kanë kontraktuar mbi **335 fermerë**. Mbështetja e ofruar për partnerët tanë konsistoi në makineri dhe shërbime këshillimore të cilat u janë ofruar fermerëve të kontraktuar me qëllim të rritjes së prodhimit, produktivitetit dhe cilësisë, në mënyrë që kontraktorët të përmbushin sasi të planifikuara/të kërkuara për tregjet e brendshme dhe të eksportit. Fermerët e kontraktuar janë të përhapur anembanë Kosovës, duke mbuluar 10 komuna/rajone (Prishtinë, Pejë, Podujevë, Ferizaj, Kaçanik, Skenderaj, Istog, Leposaviq, Rahovec, Shtime). Kontraktuesit kanë prezantuar 11 kultura të reja (specia feferona, kornishona, kamomilë, pepermint, rigon, goji berry, golden berry, kungull, lulediell dhe hithër), përveç kulturave të tjera të viteve të kaluara. Rezultati më i rëndësishëm ishte kontraktimi i mbi 137 fermerëve të rinj. PPSE-ja ka kryer një vlerësim të plotë të ndikimit me fermerët dhe kontraktorët për këtë intervenim, ku mbi 84 përqind kanë deklaruar se janë të kënaqur me bujqësinë e kontraktuar dhe vetëm 6 përqind ishin të pakënaqur. Ndër fermerët e intervistuar, tre arsyet kryesore për angazhim në prodhimin e kontraktuar janë renditur: tregu i sigurt, rentabiliteti dhe çmimi më i lartë. Këto rezultate pozitive janë regjistruar edhe pse sezoni 2018 kishte kushte të pafavorshme klimatike për bujqësinë në Kosovë, që i bëri fermerët të përballeshin me acar, vërshime dhe breshër në pranverën e vonshme. Mbi 80 përqind e fermerëve kanë raportuar rreth 50 përqind të dëmeve për shkak të motit.
- Intervenimi '**Prezantimi i prodhuesve të specializuar të fidanëve**' është zbatuar për të përmirësuar qasjen dhe cilësinë e fidanëve për perime dhe fermerët e MAP-së, me fokus në prodhimin e kontraktuar. Kjo pritet të ndikojë drejtpërdrejt në cilësinë dhe shtimin e prodhimit primar. Për të arritur këtë, PPSE-ja ka mbështetur **ngritjen e një fidanishteje të re moderne (Agrobora)** dhe përmirësimin e një fidanishteje (**Fidanishtja e Godancit**) për prodhimin e perimeve. Për më tepër, dy qendra të grumbullimit MAP (Agroprodukt dhe Peppermint) janë mbështetur për të përmirësuar fidanishtet e tyre. PPSE-ja pret që të dy fidanishtet për prodhimin e perimeve të fillojnë të shfrytëzohen për sezonin e vitit 2019. PPSE-ja vazhdimisht është duke integruar fidanishte partnere përmes intervenimit në bujqësinë kontraktuese.

⁷ Nga të gjithë fermerët e kontraktuar në vitin 2018 (mbështetur nga intervenimi i PPSE-së), 41% (137 nga 335) janë kontraktuar rishtazi. Kjo do të thotë se këta fermerë nuk kanë prodhuar më parë prodhime të kontraktuara. Ekipi i ka pyetur këta fermerë nëse kanë zëvendësuar ndonjë prodhim ekzistues për prodhimin e kontraktuar dhe 95% të rasteve kanë deklaruar se vetëm e kanë zgjeruar prodhimin për të akomoduar sasi të kontraktuara. Prandaj, PPSE-ja ka dhënë vetëm rezultate nga fermerët e kontraktuar në vitin 2018 në lidhje me punësimin.

⁸ Këto rezultate janë nxjerrë duke intervistuar 211 fermerë të kontraktuar dhe janë validuar përmes intervistave të hollësishme me kontraktorët.

3.3 Rezultati 2: NVM-të përmirësojnë ofertën, efikasitetin dhe konkurrueshmërinë e tyre në sisteme gjithëpërfshirës të tregut të cilat janë të përmirësuara dhe më të organizuara

Rezultati 2: NVM-të përmirësojnë ofertën, efikasitetin dhe konkurrueshmërinë e tyre në sisteme gjithëpërfshirës të tregut të cilat janë të përmirësuara dhe më të organizuara	Treguesi i rezultatit	Vlerësimi bazë 2017	2018 (T=Targeti, A= të arriturat)	Përqindja (%) graduale e arritur në vitin 2018	Fundi i fazës 2021	% komulative e arritur në këtë fazë
	OC 2.1 Numri i NVM-ve që përfitojnë nga përdorimi i shërbimeve të reja ose të përmirësuara mbështetëse	0	T= 38 SMEs A= 16 SMEs	42%	150 SMEs	11%
	OC 2.2 Rritja shtesë neto e të ardhurave e 150 NVM-ve	0	T= CHF 950,000 A=CHF 572,852	60%	CHF 3,800,000	15%
	OC 2.3 Institucionet janë më të përgjegjshme për rritjen e sektorit privat	0		<i>Vlerësimi cilësor bazuar në diskutimet në grupe të fokusuar të personelit kryesor të institucionit</i>		

PPSE ka lehtësuar rreth **7 shërbime të reja mbështetëse**⁹ për NVM-të e sektorit të **FNI-së**. Në vitin 2018, **11 NVM kanë përfituar nga këto shërbime të reja mbështetëse**, vetëm rreth 22% e NVM-ve të cilat kanë përdorur këto shërbime. Numri i NVM-ve që përfitojnë nga shërbime mbështetëse të reja ose të përmirësuara pritet të rritet në vitin 2019, për shkak të kohës që është dashur për të prezantuar këto shërbime mbështetëse, në radhë të parë, si dhe për NVM-të që të japin rezultatet e përdorimit të këtyre shërbimeve. NVM-të përfituese kanë raportuar të ardhura shtesë neto prej rreth **236,000 €** si rezultat i drejtpërdrejtë i intervenimit të FNI-së.

Gjatë vitit 2018, PPSE-ja ka arritur në **20 ndërmarrje të vogla dhe të mesme (5 drejtpërdrejt dhe 15 indirekt)** që kanë përfituar nga **3 shërbime të reja mbështetëse**¹⁰ të zhvilluara përmes intervenimeve të

⁹ Shërbimet mbështetëse të PPSE-së për FNI-në përfshijnë: 1. Trajnimi për rritje, 2. Studimi i fizibilitetit për Krushën, 3. Certifikimi organik, 4. Certifikimi Global GAP, 5. Konsultimi për përgatitjen dhe pjesëmarrjen në panairin Biofach, 6. Përgatitja e lidhjeve për eksportimin e produkteve MAP për në tregun zviceran, 7. Shërbimet e përshtatura të marketingut për produkte të reja.

¹⁰ Shërbimet mbështetëse të PPSE-së për turizëm përfshijnë: 1. Konsulencë për përgatitje dhe pjesëmarrje në panairin ITB dhe Destination Nature, 2. Trajnim për udhëzuesit/guidat e qytetit turistik, 3. Trajnim për kamarierë në Graçanicë.

PPSE-së. Ndërsa numri i **NVM**-ve që përfitojnë nga të gjitha intervenimet në turizëm është **84**, të cilat kanë raportuar të ardhura shtesë neto prej rreth 254,500 €. Gjithashtu, ekipi mbështetëse tre komuna dhe MTI-në për të përmirësuar planifikimin, ofertën, efikasitetin dhe konkurrueshmërinë e tyre përmes aktiviteteve të profesioneve të specializuara të turizmit, promovimit të Kosovës në tregjet ndërkombëtare dhe përmirësimit të organizimit të sektorit.

Të arriturat 2.1: Ofruesit e shërbimeve ofrojnë shërbime biznesore të përmirësuara

Të arriturat 2.1: Ofruesit e shërbimeve ofrojnë shërbime biznesore të përmirësuara	Treguesi i të arriturave	Vlerësimi bazë 2017	2018 (T=Targeti, A= të arriturat)	Përqindja (%) graduale e arritur në vitin 2018	Fundi i fazës 2021	% komulative e arritur në këtë fazë
	OP 2.1.1 Numri i NVM-ve që përdorin shërbime të reja dhe të përmirësuara të ofruara nga ofruesit e shërbimeve	0	T= 75 SMEs A= 69 SMEs	92%	300	23%

Në kuadër të **sektorit të FNI-së**, mbështetja e PPSE-së për NVM-të është fokusuar në programet e certifikimit, lehtësimin e tregtisë, informimin e fermerëve, marketingun dhe zhvillimin e shërbimeve të produktit dhe zhvillimin e biznesit. Nëpërmjet intervenimit **'Lehtësimi i programeve të certifikimit'**, PPSE-ja ka arritur partneritet me BMO-të e sektorit (Organika dhe Mjeda e Kosovës) duke i mbështetur ato me heqjen e shpenzimeve të Certifikimit Organik, BioSuisse dhe Global GAP për anëtarët e BMO-së. Në partneritet me shoqatën e shitësve të lëndës së parë (SHTIB), PPSE-ja është duke zbatuar intervenimin **'Shërbimet e përmirësuara të informacionit'**, me qëllim të përmirësimit të rrjedhës së informacionit dhe cilësisë nga shitësit e lëndës së parë¹¹ tek fermerët. PPSE-ja ka pilotuar intervenimin **'Lehtësimi i shërbimeve të marketingut'**, duke mbështetur një NVM me shërbime të përshtatura të marketingut rreth promovimit të produkteve të reja. Kjo do të zgjerohet më tej në vitin 2019. Shërbime të tjera mbështetëse janë lehtësuar nëpërmjet intervenimeve në rezultate të tjera (p.sh lehtësimi i tregtisë sipas OP-së 2.2).

Në tërësi, të paktën **11 NVM** tashmë kanë përfituar shërbime mbështetëse të ofruara nga PPSE-ja, nga **49 NVM** që kanë përdorur këto shërbime. Numri i NVM-ve përfituese dhe përfitimi në të ardhura pritet të rritet ndjeshëm gjatë vitit 2019. Duke mbështetur BMO-të për ofrimin e programeve të certifikimit, PPSE-ja gjithashtu ka kontribuar në **rritjen e numrit të NVM-ve anëtare në këto BMO**. Në Organika, numri i NVM-ve anëtare në vitin 2017 ishte 5 krahasuar me 32 NVM deri në fund të vitit 2018.

- Përmes intervenimit **'Lehtësimi i programeve të certifikimit'**, PPSE-ja ka lehtësuar Certifikimin Organik, **ku 25 (9 për herë të parë) nga 27 NVM** aplikuese janë certifikuar me certifikim organik, 2 NVM me certifikim BioSuisse dhe 3 prodhues të boronicave me certifikim Global GAP. PPSE-ja mbështetëse kostot e certifikimit për NVM-të (50% për NVM-të e reja aplikuese dhe 25% për ricertifikim). Shërbimet për certifikim organik ofrohen përmes Organika (Shoqata NWFP dhe kompanitë e MAP-it) nga institucioni certifikues Albinspekt nga Shqipëria, ndërsa certifikimi

¹¹ Barnatoret e vogla bujqësore.

Global GAP përmes shoqatës Mjedra e Kosovës (Shoqata e prodhuesve të frutave të buta) nga GAP Plus nga Kosova. Përveç kësaj, PPSE-ja ka mbështetur shoqatën Organika për të prezantuar një shërbim të ri, në përgatitjen e aplikuesve (anëtarët e shoqatës) në përputhje me certifikimin organik. Duke marrë parasysh se certifikimi është zbatuar gjatë gjithë vitit 2018, NVM-të do të shfrytëzojnë përfitimin e këtij certifikimi në vitin 2019 duke rritur shitjet dhe të ardhurat dhe qasjen në tregjet e reja të eksportit. Sipërfaqja e tokës së kultivuar me kultura organike është rritur nga 204 ha në vitin 2017 në 506 ha në 2018, ndërsa 36% e territorit të Kosovës është e certifikuar me certifikim organik për vjeljen e frutave të egra. 90% e rritjes së tokës së kultivuar me kultura organike dhe për vjeljen e bimëve të egra i atribuohet PPSE-së.

- Intervenimi **'Shërbimet e përmirësuara të informacionit'** synon të përmirësojë sistemin dhe cilësinë e ofrimit të informacionit nga farmacitë bujqësore tek fermerët. Aktivitetet në kuadër të këtij intervenimi janë duke vazhduar dhe përfshijnë një vlerësim bazë të inputeve bujqësore dhe shpërndarjen e informacionit në Kosovë, shkëmbim vizitash për të mësuar nga praktikat më të mira rajonale, trajnimet për farmacitë bujqësore dhe tryezat e rrumbullakëta për tema të lidhura me këtë sektor. Këto aktivitete do të ndikojnë tek së paku **35 barnatore bujqësore** në rajonet më të mëdha të Prizrenit dhe Pejës, të cilat do të identifikohen në bazë të rritjes dhe klientelës së fermerëve.
- PPSE-ja ka pilotuar intervenimin **'Lehtësimi i shërbimeve të marketingut'** duke lidhur një ndërmarrje të vogël (Ananas Impex) me një agjenci lokale të marketingut (Trokit). Çiftëzimi (ang. matchmaking) është bërë përmes bashkëfinancimit të kostove të marketingut të një shërbimi të përshtatur, i projektuar posaçërisht për promovimin e produkteve të reja. Janë planifikuar aktivitete të mëtejshme për të rritur shërbimet e marketingut të përshtatura për NVM-të në sektorin e ushqimit, me fokus të NVM-të partnere të PPSE-së që të prezantojnë produkte të reja - të lidhura me arriturat 1.1. Këto shërbime të marketingut përfshijnë brendimin, dizajnimin, promovimin, marketingun inteligjent dhe planet e marketingut. Agjencitë e marketingut në përgjithësi i kanë ofruar këto shërbime kompanive më të mëdha. Shfrytëzimi i shërbimeve të përshtatura të marketingut mund të ndihmojë NVM-të për të rritur shitjet si dhe për të rritur biznesin.
- NVM-të e sektorëve të FNI-së gjithashtu janë mbështetur me shërbime të tilla si lehtësimi i tregtisë, zhvillimi i shërbimeve të produktit dhe zhvillimi i biznesit përmes intervenimeve të rezultateve të tjera. Këtu përfshihen intervenimet: **'Trajnimi për rritje'**, **'Mbështetja e lidhjeve tregtare'**, misionet SEC etj.

Në sektorin e **turizmit**, mbështetja është fokusuar në trajnimet joformale për profesionet e kërkuara të turizmit dhe mikpritjes dhe në shërbimet për mbështetjen e operatorëve turistikë për pjesëmarrje në panairë. Në kuadër të intervenimit **'Profesionet e specializuara turistike'** janë përkrahur tre trajnime të shkurtëra joformale, dy për udhëzuesit/guidat turistike dhe një për kamariere/kamarierë. Në bashkëpunim me operatorët e shërbimeve turistike lokale (Svonon) që morën pjesë në panairët ITB Berlin dhe DN Paris janë mbështetur për përgatitje dhe prezantim më të mirë, në mënyrë që ata të mund të kenë qasje më të mirë në kanalet e reja të shitjeve gjatë dhe pas periudhës së panairit.

Rezultatet e deritanishme tregojnë se të paktën **20 NVM** kanë përdorur **tre shërbime të reja** të mbështetura dhe kanë angazhuar udhëzuesit e trajnuar. Si rezultat i trajnimeve joformale të PPSE-së, **30 guida dhe kamerierë (10 nga komuniteti serb)** janë angazhuar në bizneset e turizmit dhe mikpritjes, duke arritur në **11 FTE (9 serbë)**.

- Intervenimi **'Profesionet e specializuara turistike'** përfshinte prezantimin e dy trajnimeve joformale, një për udhëzues/guida turistike të qytetit dhe një për kamariere/kamarierë. Rezultatet nga një trajnim për guidat malore i mbështetur në vitin 2017, tregojnë një numër në rritje të pjesëmarrësve të trajnuar si guida malorë. Për organizimin e guidave turistike të qytetit, është kryer një vlerësim paraprak me rreth 15 biznese turistike (hotele, bujtina, restorante,

operatorë turistikë) për të kuptuar kërkesën e tregut për guida. Rezultatet tregojnë se kishte kërkesa të mëdha për guida dhe se bizneset ishin të gatshme t'i angazhonin ato/ata. Prandaj, PPSE-ja ka kontraktuar Gearsup Solution për të ofruar një trajnim për guidat e qytetit. Trajnimi për kamariere/kamariere është organizuar nga TOG (Organizata e Turizmit në Graçanicë) si rezultat i kërkesës nga restorantet në Graçanicë. Në total, 51 persona (39 nga komuniteti serb) janë trajnuar nga dy trajnimet e mbështetura.

Të arriturat 2.2: NVM-të kanë përmirësuar qasjen në kanalet e shitjes

Të arriturat 2.2: NVM-të kanë përmirësuar qasjen në kanalet e shitjes	Treguesi i të arriturve	Vlerësimi bazë 2017	2018 (T=Targeti, A= të arriturat)	Përqindja (%) graduale e arritur në vitin 2018	Fundi i fazës 2021	% komulative e arritur në këtë fazë
	OP 2.2.1 Numri i NVM-ve që përdorin kanale të reja dhe të përmirësuara të shitjeve	0	T=75 SMEs A= 40 SMEs	53%	300	13%
	OP 2.1.2 Numri i aktiviteteve të përbashkëta promovuese për segmentet e tregut	0	T= 13 A= 11	85%	50	21%

Mbështetja e PPSE-së për NVM-të në sektorin e ushqimit dhe përbërësve natyral në drejtim të përmirësimit të qasjes në kanalet e shitjeve është përqendruar kryesisht në promovimin e eksporteve. Ekipi ka zbatuar intervenimin '**Mbështetja e lidhjeve tregtare**', për promovimin e eksportit të produkteve të freskëta dhe të përpunuara. Në partneritet me shoqatat e sektorit (Organika dhe SHKF - shoqata e prodhuesve të frutave), është ofruar përkrahje për ekspozim të produkteve dhe pjesëmarrje në dy panairë dhe organizimin e misionëve të shitjeve dhe blerësve. Për të promovuar prodhimet ushqimore dhe prodhuesit në tregun vendor, ekipi ka pilotuar mbështetjen për një shfaqje televizive (Toka Jonë).

Rreth 11 NVM kanë qenë pjesë e të gjitha aktiviteteve promovuese të eksportit të PPSE-së. Rezultate të dukshme janë arritur nga ekspozimi i NVM-ve në panairin Biofach, me shitje të kontraktuara shtesë rreth 870,000 franga, vetëm në vitin 2018. Për më tepër, më shumë partneritete afatgjate janë iniciuar përmes misionit të shitjes dhe të blerësve me kompanitë zvicerane. Intervenimi '**Mbështetja e lidhjeve tregtare**' ka kontribuar në rezultatet vjetore me mbi 120 FTE.

- Ndërhyrja '**Mbështetja e lidhjeve tregtare**' është zbatuar për të rritur eksportet e NWFP-së dhe frutave në tregun e BE-së, me fokus në produktet organike. Në partneritet me Organika, ekipi ka mbështetur pjesëmarrjen dhe ekspozimin e 7 NVM-ve NWFP në panairin BioFach në Nuremberg të Gjermanisë. Si rezultat i këtij panairi, janë nënshkruar 16 kontrata me blerësit

ndërkombëtarë, të cilët përbëjnë 382 tonë për 32 produkte. Kjo ishte hera e parë që Kosova kishte një 'shtand' në këtë panair. PPSE-ja së bashku me anëtarët e shoqatës Organika ka bashkë-financuar shtandin e Kosovës në vitin 2018 dhe është përkrahur me shërbime konsulence për çiftëzim (ang. matchmaking) gjatë dhe pas periudhës së panairit. Mbështetja për ekspozim në panair është marrë përsipër nga KIESA për vitin 2019 dhe prandaj PPSE-ja ka tërhequr mbështetjen e saj. PPSE-ja ka intensifikuar fokusin për promovimin e produkteve organike të Kosovës në tregun zviceran nëpërmjet bashkë-lehtësimit të një kompanie zvicerane - Triple E¹². Një mision shitjesh në Zvicër dhe një mision blerësish në Kosovë ka rezultuar me 3 kompani të Kosovës (Eurofruti dhe Agroproduct & Peppermint) të cilat kanë nënshkruar marrëveshje me 2 kompani zvicerane (Biopartner, përkatësisht Erboristi Len-di). Dërgesat e para pritet të ndodhin në 3 muajt e parë të vitit 2019. Përveç shitjeve, vlen të përmendet se dy NVM janë certifikuar me certifikatën BioSuisse, e cila është e detyrueshme për eksportimin e produkteve organike në Zvicër, ndërsa Eurofruti do të mbështetet nga Biopartner me marrjen e certifikatës BioSuisse. Gjithsej, 6 komuna lokale dhe 4 NWFP zvicerane ishin pjesë e këtyre misioneve. Së fundi, 3 prodhues të mollëve të Kosovës janë mbështetur për pjesëmarrje në panairin InterPoma në Itali, për të eksploruar potencialin për eksport dhe për të mësuar praktikat më të mira në lidhje me prodhimin dhe organizimin e mollës.

- Lidhur me promovimin lokal, në dhjetor, projekti ka filluar të punojë me Moments Media për të financuar disa episode të emisionit "Toka Jonë", një program televiziv javor që transmetohet në Klan Kosova për të promovuar prodhuesit/produktet vendore. Bashkëpunimi me këtë agjenci do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2019. Përveç promovimit të produkteve vendore, përmes këtij emisioni televiziv synohet edhe edukimi i audiencës lidhur me produktet, cilësinë e tyre dhe përmirësimin e perceptimit të produkteve dhe rritjen e shitjeve tek prodhuesit vendor.

Në kuadër të sektorit të **turizmit, 29 ndërmarrje të vogla dhe të mesme** kanë përdorur kanale të reja dhe të përmirësuara të shitjes përmes mbështetjes së ofruar për **7 aktivitete të përbashkëta promovuese**. Përveç kësaj, 6 NVM të cilat janë mbështetur në vitin 2017, gjithashtu kanë përfutur edhe në vitin 2018. Aktivitetet të cilat janë mbështetur në kuadër të intervenimit '**Promovimi ndërkombëtar**' përfshijnë mbështetje për pjesëmarrjen në panaire (ITB Berlin dhe DN Paris) dhe organizimin e udhëtimeve të familjarizimit dhe udhëtime me gazetarë për segmentet e tregut në Azi dhe Belgjikë. Për më tepër, PPSE-ja ka mbështetur një operator turistik (BNA) për promovim në mediat e specializuara (Wanderlust UK, Swiss Alpine Magazine) dhe ka organizuar një udhëtim për zbulimin/evidentimin e vendeve për filmbërësit.

Operatorët turistikë përfitues kanë raportuar mbi **7,500 turistë shtesë** të cilët vijnë si rezultat i panaireve të mbështetura nga PPSE-ja gjatë vitit 2017 dhe 2018. Këta turistë shtesë të cilët kanë ardhur kanë gjeneruar qarkullim prej rreth **1,100,000 €** për rreth **68 NVM** turistike të Kosovës.

- Sektori i turizmit i PPSE-së përmes intervenimit '**Promovimi ndërkombëtar**' ka mbështetur NVM-të për pjesëmarrje në panaire ndërkombëtare, udhëtime të familjarizimit/udhëtime me gazetarë, promovim në media të specializuara dhe krijim të lidhjeve biznesore nëpërmjet takimeve B2B (Biznes me biznes) dhe B2C (Biznes me konsumatorë). PPSE-ja ka lehtësuar promovimin më të mirë të pesë operatorëve turistikë për turiste hyrës dhe krijimin e lidhjeve biznesore me ITB Berlin dhe DN Paris përmes një ofruesi lokal të shërbimeve (Svonon). Lidhur me organizimin e udhëtimeve të familjarizimit/udhëtimeve me gazetarë, PPSE-ja ka mbështetur dy udhëtime me gazetarë - një me **7 gazetarë nga Koreja e Jugut** dhe tjetri me **6 gazetarë japonezë** dhe një udhëtim të familjarizimit me 9 operatorë turistik nga Japonia. Këto aktivitete

¹² www.eeexport.com

janë organizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës (MPJ), ndërsa kompania Turkish Airlines është kontribuesi kryesor, duke paguar të gjitha biletat e fluturimit për pjesëmarrësit. Këto aktivitete po bashkë-lehtësohen nga Ambasada e Kosovës në Japoni. PPSE-ja ka financuar organizimin e aktiviteteve në vend përmes akterëve të turizmit të cilët kontribuojnë në koston e transportit, akomodimit dhe shpenzimeve të tjera. Në bashkëpunim me MPJ-në, PPSE-ja gjithashtu ka mbështetur një udhëtim të familjarizimit, me **12 operatorë turistikë belgë, gazetarë dhe guida që vizituan Kosovën gjatë muajit nëntor**. PPSE-ja ka mbështetur një tjetër udhëtim rajonal të familjarizimit (pjesa në Kosovë) me 52 operatorë turistikë të Azisë dhe Lindjes së Mesme, e cila është organizuar nga **Travel Shop Turkey dhe Travel Shop**. Një iniciativë tjetër ishte mbështetja që iu është ofruar operatorit turistik BNA, për të promovuar ofertën në revistën **Financial Times, Wanderlust UK dhe revistën Swiss Alpine**. Përderisa ekipi pritet të ketë rezultate nga organizimi i udhëtimeve të familjarizimit dhe udhëtimeve me gazetarë, pjesëmarrja në panairë dhe promovimi në mediat e specializuara, tashmë kanë rezultuar si shumë të suksesshme në tërheqjen e një numri të madh të turistëve ndërkombëtarë në Kosovë (mbi 7,500 turistë).

- Gjithashtu, PPSE-ja ka mbështetur një udhëtim për zbulimin/evidentimin e vendeve për filmbërësit, të cilët morën pjesë në festivalin e filmit Prifilm fest. Ky aktivitet ka përfshirë 19 filma ndërkombëtarë dhe është bërë me qëllim të promovimit të Kosovës në industrinë e filmave ndërkombëtare si një destinacion për filmim.

Të arriturat 2.3: Palët e interesuara kanë përmirësuar organizimin e sektorit dhe rrjetëzimin

Të arriturat 2.3: Palët e interesuara kanë përmirësuar organizimin e sektorit dhe rrjetëzimin	Treguesi i të arriturave	Vlerësimi bazë 2017	2018 (T=Targeti, A = të arriturat)	Përqindja (%) graduale e arritur në vitin 2018	Fundi i fazës 2021	% komulative e arritur në këtë fazë
	OP 2.3 Numri i iniciativave të përbashkëta për përmirësimin e rrjetëzimit dhe organizimin e sektorit rreth temave të përzgjedhura: menaxhimi i mbeturinave, segmentet e tregut, promovimi, koordinimi dhe shkëmbimi i njohurive	0	T=3 A= 4	133%	10	33%

Në vitin 2018, ekipi i **FNI**-së ka bashkëpunuar me BMO-të e sektorit dhe grupet ad-hoc të NVM-ve në ndërhyrjet dhe aktivitetet tematike (në kuadër të rezultateve të tjera). Janë organizuar iniciativa të përbashkëta në lidhje me promovimin me shoqatën Organika dhe SHKF (prodhuesit e mollëve). Aktivitetet e përbashkëta për shkëmbimin e njohurive janë mbështetur në bashkëpunim me CEED, SHTIB (furnizuesit e lëndës së parë), Agrocelina dhe SHKF. Programet e certifikimit janë lehtësuar përmes shoqatës Organika dhe Mjedra e Kosovës. Këto ndërhyrje dhe aktivitetet kanë kontribuar në rritjen e anëtarësisë dhe në rritjen e ndikimit të BMO-ve sektoriale. Duke qenë të fokusuar në organizimin e sektorit, PPSE-ja ka mbështetur **'Konventën e tregtisë'** të organizuar nga KMC, ku janë trajtuar tema të tilla si vonesa në pagesa, hendeku i fuqisë punëtore, praktika të padrejta tregtare etj. Për më tepër, Instituti Riinvest ka mbështetur ekipin përmes eksplorimit dhe analizimit të sektorit të

konditorisë nëpërmjet intervistave dhe diskutimit të një grupi të fokusuar. Bazuar në gjetjet e hulumtimit, PPSE-ja ka vendosur të shqyrtojë mundësitë për të mbështetur sektorin e konditorisë në përmirësimin e kanaleve të shitjes.

Në sektorin e **turizmit**, PPSE-ja ka lehtësuar aktivitetet rreth **tre çështjeve të organizimit të sektorit**: Ligjin e Turizmit, strategjitë e turizmit për Komunën e Prishtinës dhe të Prizrenit. Ligji për Turizëm është hartuar dhe pritet të miratohet në fillim të vitit 2019, ndërsa strategjia e turizmit në Prishtinë është miratuar nga kuvendi komunal. Për më tepër, projekti ka kryer një vlerësim dhe aktivitete përcjellëse lidhur me ndalimin e mundshëm të qeseve plastike në Kosovë.

- PPSE-ja ka mbështetur MTI-në për hartimin e **Ligjit për Turizëm** duke siguruar ekspertizë dhe duke siguruar përfshirjen e sektorit privat. Janë organizuar dy punëtori nga MTI-ja, gjatë së cilës akterët e turizmit të sektorit privat kishin mundësinë të shprehnin mendimin e tyre dhe të siguroheshin që barrierat administrative ndaj subjekteve të sektorit privat të reduktohen në maksimum. Ligji pritet të miratohet nga Qeveria në mars të vitit 2019. Ndryshimi kryesor është futja e profesionit të guidave turistike dhe sigurimi i fondeve për departamentin e sapo krijuar të turizmit me MTI-në.
- PPSE-ja ka mbështetur Komunën e Prishtinës dhe Komunën e Prizrenit për zhvillimin e **strategjive të turizmit**. Kjo është lehtësuar nëpërmjet ekspertizës duke zbatuar metodologjinë SGDM me palët e interesuara të turizmit në Prishtinë dhe Prizren, në identifikimin dhe priorizimin e flukseve kryesore të vizitorëve nga perspektiva e ofertës. Strategjia e turizmit në Prishtinë është miratuar edhe nga kuvendi komunal. Disa rezultate të menjëhershme të strategjisë janë ri-funksionalizimi i pikës së informacionit të turizmit, vendosja e 45 paneleve/monoliteve informative mbi pikat e interesit në të gjithë qytetin. Strategjia e turizmit për Komunën e Prizrenit pritet të miratohet nga kuvendi komunal në fillim të vitit 2019.
- Për të trajtuar tema rreth menaxhimit të mbeturinave, PPSE-ja ka komisionuar një studim (white paper) për ndalimin e qeseve plastike. Të gjeturat preliminare të vlerësimit janë ndarë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). Të gjeturat paraqesin tre modalitete kryesore për të ecur përpara: tatimi mbi qeset plastike, zëvendësimi i çantave jo-biodegraduese, ndalimi i qeseve plastike. Duke pasur parasysh gatishmërinë e zyrtarëve të MMPH-së, PPSE-ja do të mbështesë aktivitete të tilla si tryeza të rrumbullakëta për të koordinuar sektorin publik dhe atë privat në gjetjen e modalitetit më të mirë të përbashkët për këtë çështje. Këto aktivitete pritet të fillojnë në janar të vitit 2019.

3.4.1. Fondi i mundësive

Në vitin 2018 OF (së këndejmi OF; Fondi i mundësive; ang. Opportunity fund) është përdorur si një instrument shtesë për sektorët. Mundësitë që plotësojnë intervenimet e sektorit janë duke u identifikuar në mënyrë të vazhdueshme nga lehtësuesit e sektorit, lehtësuesi i minoriteteve dhe menaxheri i OF-së. Të gjitha marrëveshjet e bashkë-investimeve për vitin 2018 ishin në sektorin e FNI-së, të cilat kanë plotësuar intervenimet e vazhdueshme në këtë sektor. Udhëzuesi operativ i OF-së është adaptuar në tremujorin e parë të vitit 2018, në mënyrë që të jetë zgjidhje më e përshtatshme për intervenimet e sektorit të fazës së II-të dhe investimet për një model të qëndrueshëm të biznesit. Pasi që ndërhyrjet e OF-së janë të integruara me sektorë, të gjitha rezultatet e lidhura me OF-të janë raportuar sipas sektorëve dhe rezultateve përkatëse të projektit. PPSE-ja ka pranuar **33 shprehje të interesit, 9 aplikues kanë pasur mundësi të zhvillonin koncept dokumentet dhe janë nënshkruar 3 marrëveshje bashkë-investimi sipas buxhetit të planifikuar për vitin 2018.**

Marrëveshja e parë bashkë-investuese është nënshkruar me një kompani serbe - **Peppermint International**, me lokacion në komunën e Leposaviqit. Qëllimi i marrëveshjes bashkë-investuese ishte rritja e kapaciteteve të përpunimit dhe prodhimi i fidaneve nga kompania Peppermint, e cila operon në sektorin e MAP-ve dhe është një kontraktues i rëndësishëm për fermerët në veri të Kosovës. Rritja e kapaciteteve të përpunimit ka mundësuar që kompania Peppermint të rrisë kërkesën për prodhimin e MAP-ve, si dhe të rrisë eksportet e saj. Kompania Peppermint është një prodhues i vajrave esenciale dhe aktualisht eksporton shumicën e prodhimit të saj. Projekti pothuajse ka përfunduar, tani kompania Peppermint është duke pritur vetëm një makinë për paketim, të cilën e ka porositur në Serbi, ardhja e së cilës është ende pezull për shkak të çështjes së rritjes së taksës, së fundi.

Marrëveshja e dytë bashkë-investuese për vitin 2018 ishte për krijimin e fidanishteje moderne për prodhimin e farërave të perimeve. PPSE-ja ka nënshkruar këtë projekt me kompaninë **Agrobora**, një kompani nga komuna e Skenderaj-it, pas një procesi përzgjedhës përmes një thirrjeje për propozim me 13 kompani. Marrëveshja parashikon ngritjen e serrës me 0.2 ha me pajisje moderne për prodhimin e farërave të perimeve. Ky intervenim do të kontribuojë në adresimin e çështjes së qasjes dhe cilësisë së farërave të perimeve, me fokus në bujqësinë e kontraktuar. Zbatimi i projektit ka qenë më i ngadalshëm se sa pritej për shkak të njohurive të kufizuara për ndërtimin dhe pajisjen e një fidanishteje moderne të specializuar. PPSE-ja ka ndihmuar kompaninë Agrobora përmes punësimit të një konsulenti të jashtëm për zbatim të suksesshëm të projektit. Si aktivitet pasues, është nënshkruar një marrëveshje shtesë ndërmjet kompanisë Agrobora dhe PPSE-së, duke specifikuar të gjitha investimet e mëtejme që do të ndërmerren nga Agrobora për përfundimin e projektit. Ekipi pret që fidanishtet do të jenë funksionale deri në muajin mars.

Marrëveshja e tretë bashkë-investuese është nënshkruar me kompaninë **Produkte Natyrale të Kosovës (PNK)**, e cila ndodhet në komunën e Pejës, me qëllim të përmirësimit dhe modernizimit të linjës së përpunimit për përpunimin e farave të kungujve. Gjithashtu, ky projekt e ka plotësuar sistemin e bujqësisë kontraktuese, pasi që investimi i ka mundësuar PNK-së që të prezantojë një produkt të ri (farat e lulediellit) dhe të rrisë numrin e fermerëve të kontraktuar dhe sasinë e produkteve të blera. Ky investim i mundëson PNK-së të shfrytëzojë mundësitë për promovimin e eksporteve si dhe të depërtojë në tregun vendor. Për më tepër, linja e re e përpunimit mund të përdoret gjithashtu për produkte dhe akterë të tjerë (p.sh. Agroprodukt për dëllinjë). PNK ka përfunduar me sukses projektin dhe një ceremoni inaugurimi është organizuar më 11 dhjetor 2018.

3.4.2. Fondi për Përfshirjen Sociale

Në vitin 2018, nëpërmjet Fondit për përfshirjen sociale, PPSE-ja ka zbatuar pesë partneritete, me tre intervenime: menaxhimin e mbeturinave, prodhimin e bio-peletit dhe trajnimin e kameriereve/kamarierëve si dhe ka bërë dy vlerësime: një studim fizibiliteti për ndërmarrjen sociale TOKA dhe një vlerësim për stereotipat gjinore për zgjedhjet arsimore në partneritet me Qendrën LEAP dhe në bashkëpunim me projektin EYE.

Në bashkëpunim me sektorin publik dhe privat, SIF ka zbatuar një intervenim në lidhje me menaxhimin e mbeturinave në komunën e Graçanicës, ku komuniteti RAE ishte në shënjestër. Përmes këtij intervenimi, kompania G-Plus ka rritur kapacitetet e përpunimit të mbeturinave plastike dhe si rezultat ka dyfishuar eksportet e tyre. Gjithsej janë krijuar **26 FTE** të reja, 6 brenda objektit dhe 20 grumbullues të mbeturinave. Pothuajse të gjithë këta persona që përfitojnë vijnë nga komuniteti RAE. Për më tepër, tre grumbullues të vegjël të përpunimit janë mbështetur me makina të vogla shtypëse, të cilët do të jenë plotësisht funksionale në vitin 2019.

Intervenimi në lidhje me prodhimin e bio-peletit është nënshkruar me një kompani në pronësi të minoriteteve në fund të vitit 2018. Ky intervenim do të zbatohet dhe monitorohet në vitin 2019 dhe synon të rrisë kapacitetin prodhues dhe cilësinë e prodhimit të peletit në Novobërdë. Intervenimi në lidhje me trajnimin e kamarierëve/kamarierëve është raportuar në kuadër të pjesës së turizmit.

4. Temat transversale

4.1. Përfshirja Sociale

Pjesët e mëposhtme përfaqësojnë integrimin e pakicave në intervenimet e sektorit të FNI-së dhe sektorit të turizmit për këtë periudhë raportuese.

Përfshirja e pakicave në intervenimet e FNI-së:

- Shembujt e suksesshëm të FNI-së për integrimin dhe intervenimet e shënjestruara në vitin 2018 ishin bujqësia e kontraktuar dhe kompania Peppermint International përmes fondit të mundësive. Në mesin e fermerëve të rinj të kontraktuar, 47 punonjës të komunitet RAE (13% femra) ishin angazhuar shtesë - që arrin në 5 FTE, ndërsa numri i punëtorëve serbë shtesë ishte 42 (rreth 40% femra) që arrinin në 15 FTE. Numri i personave përfitues që vijnë nga komunitetet minoritare mes të gjithë fermerëve (përfshirë ato të kontraktuara edhe në vitin 2017) ishte 152 persona (RAE me 64%). Të paktën 27 fermerë serbë janë kontraktuar nga përpunuesit në vitin 2018.
- Në kuadër të misionit të SEC-ut në Kosovë, 2 biznese të pakicave janë mbështetur nga ekspertë, një për përmirësimin e shitjeve dhe shërbimeve të marketingut dhe tjetra për përmirësimin e recetave dhe cilësisë së produkteve.

Përfshirja e pakicave në intervenimet e turizmit:

- Në kuadër të sektorit të turizmit, përkrahja për trajnimin e kamarierëve (e organizuar nga TOG në Graçanicë) është dëshmuar si mjaft e suksesshme. Rreth 40 serbë të rinj nga zonat rurale janë trajnuar për profesionin e mikpritjes nëpërmjet një trajnimi afatshkurtër të ofruar nga trajnuesi i certifikuar. Nga të gjithë pjesëmarrësit e trajnuar, 10 persona ishin të punësuar në bare dhe restorante lokale. Organizatori i trajnimit, TOG, ka vazhduar të ofrojë trajnime të njëjta për aplikuesit e tjerë të interesuar pa mbështetjen e PPSE-së.

4.2. Gjinia

- Intervenimet e FNI-së kanë gjeneruar **162 nga 356 FTE ose 45%**, ndërsa nga **1579** persona të punësuar me paga, **644 ose 40%** prej tyre janë gra. Sa i përket fermave përfituese në pronësi të grave, **111 nga 335 ose 33%** janë në pronësi të grave. Intervenimet e PPSE-së (bujqësia kontraktuese, trajnime për rritje, programet e certifikimit etj.) kanë përfshirë 8 NVM në pronësi të grave (99 Lule, Biofruti, Krusha Coop, Bliff, R Company, Trboljevac dhe Vicianum dhe Sweet Pop). Përveç sigurimit të përfshirjes gjinore në intervenimet e të gjithë sektorit, ekipi i PPSE-së ka mbështetur dy NVM në pronësi të grave (Sabaja dhe KS Foods) për pjesëmarrje në **panairin SIAL** në Paris, Francë. Për më tepër, PPSE-ja ka mbështetur nisjen e iniciativës globale për Ecjen e Mentorimit Global ang. Global Mentoring Walk në Kosovë nga e cila 100 gra ishin pjesë e

procesit (50 mentorë të përshtatur me 50 të mentoruar). Ky program do të vazhdojë në baza vjetore pa mbështetjen e PPSE-së.

- Në sektorin e turizmit, **8 nga 19** guidat turistike të qytetit të trajnuara ishin gra. Pjesëmarrësit e trajnuar tashmë veprojnë në treg, duke u kontraktuar në bazë të nevojave të operatorëve turistikë. Përveç kësaj, ekipi i turizmit i PPSE-së ka lehtësuar procesin e qasjes në kanalet e reja të shitjes në ‘Pyllin e Arinjve’ për bizneset në pronësi të grave që prodhojnë suvenire të punuara me dorë.

5. Konsulenca

Gjatë periudhës raportuese janë ekzekutuar gjithsej 50 ditë të konsulencës afatshkurtër (41 ditë për konsulencë kombëtare dhe 9 ditë për konsulencë ndërkombëtare).

Konsulentët ndërkombëtarë janë angazhuar për të mbështetur kompanitë e produkteve pyjore jo-drusore, për të krijuar lidhje biznesi në panairin Biofach në Nurnberg në Gjermani dhe për të mbështetur investimet e një fidanishte të specializuar të farërave.

Konsulentët kombëtarë janë angazhuar në aktivitetet e mëposhtme: të mbështesin NVM-të e turizmit për të krijuar lidhje biznesi në panairin ITB, Gjermani; të kryejnë një vlerësim mbi vendet publike historike, kulturore, arkeologjike të Kosovës; të lehtësojnë mbajtjen e një punëtorie për përpunimin e ushqimit për akterët e zinxhirit të vlerës së përbërësve natyralë, anketën e ofertës së turizmit.

Në kuadër të rezultateve të pjesës së IV-të, janë angazhuar 93 ofrues kombëtar të shërbimeve dhe 46.5 ofrues ndërkombëtarë të shërbimeve. Këto aktivitete shpjegohen në kuadër të çdo fushe të të arriturave si dhe intervenimeve.

Një listë e përgjithshme e konsulencave me informacione në lidhje me objektivat e angazhimit mund të gjendet në Aneksin III.

7.2.1. Drejtimi i projektit

Organi kryesor për drejtimin e projektit është Komiteti Drejtues, i kryesuar me rradhë nga SDC-ja dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI). Anëtarët e tjerë përfshijnë palët relevante të sektorit publik dhe privat si janë: Agjencia Kosovare e Punësimit, Dhoma e Tregtisë së Grave të Kosovës dhe menaxheri për Kosovë i kompanisë zvicerane Roche. Komiteti Drejtues i PPSE-së është takuar në janar të vitit 2018 për të shqyrtuar planin vjetor të veprimit për vitin 2018 dhe raportin e përfundimit të fazës së parë. Të dy raportet janë miratuar. Komiteti drejtues i PPSE-së është mbledhur për herë të dytë më 30 tetor të vitit 2018, për të miratuar raportin gjashtëmujor. Raporti është miratuar. Takimi i tretë i komitetit drejtues do të mbahet më 28 mars të vitit 2019. Pikat kryesore të agjendës së takimit do të jenë miratimi i planit vjetor të punës për vitin 2019 dhe raporti vjetor i vitit 2018.

Me qëllim që takimet e komitetit drejtues të bëhen më dinamike dhe t'u ofrojnë anëtarëve më shumë njohuri për zhvillimin e projektit, para mbledhjes së ardhshme, PPSE-ja do të organizojë një udhëtim në terren për anëtarët e saj. Gjithashtu, anëtarët shtesë, mundësisht nga sektori privat, do të ftohen në komitetin drejtues. Organi këshillëdhënës, Paneli për shqyrtimin strategjik (SRP) së bashku me Institutin Riinvest dhe SC-në, kanë shqyrtuar planin vjetor operativ në muajin shkurt dhe dhjetor si dhe kanë shqyrtuar raportin gjashtëmujor. Poashtu, kanë ndodhur edhe shkëmbime të tjera të rregullta midis dy partnerëve të konsorciumit.

Gjatë periudhës raportuese, në nëntor të vitit 2017, Drejtori Ekzekutiv i Swisscontact-it, Drejtori Rajonal dhe një grup i deleguar i anëtarëve të Bordit të Mirëbesimit të Swisscontact-it kanë vizituar PPSE-në për t'u njohur me aktivitetet e projektit dhe partnerët. Vizita e Zëvendës Drejtorit Ekzekutiv të Swisscontact-it dhe drejtorit rajonal të SC-së është zhvilluar në fillim të muajit qershorit të vitit 2018. Gjatë kësaj vizite është zhvilluar një shkëmbim vizitash me kryetarin e komunës së Prizrenit.

PPSE-ja ishte në kontakt të ngushtë me SDC-në gjatë gjithë vitit dhe ka pasur një koordinim të ngushtë dhe takime që lidhen me planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve në vitin e parë të fazës së II-të të PPSE-së.

7.2.2. Monitorimi dhe matja e rezultateve

PPSE-ja ka vazhduar të ndjekë udhëzimet e MRM-së së Swisscontact-it dhe standardin DCED për zbatimin e sistemit të monitorimit dhe matjes së rezultateve. Në vitin 2018, fillimisht i është kushtuar punë dokumentimit të intervenimit, dhe më pas fokusi ka kaluar në matjet e rezultateve dhe vlerësimet e ndikimit. Ekipi ka zhvilluar dokumentacionin e intervenimit të MRM-së (konceptet dokumentet, zinxhirët e rezultateve, planet e MRM-së dhe planet e intervenimeve) për intervenimet e mëposhtme: 'Zhvillimi i produkteve të turizmit', 'Promovimi ndërkombëtar,' Atraksionet turistike ',' Trajnim për rritje ',' Sistemi i bujqësisë së kontraktuar,' Prodhuesit e specializuar të farërave 'dhe' Programet e certifikimit '.

Përmes vlerësimit të ndikimit të zhvilluara në sektorin FNI dhe në sektorin e turizmit, janë mbajtur intervista të thëlluara me partnerët e PPSE-së nga të gjitha ndërhyrjet dhe intervista me 211 fermerë lidhur me intervenimin 'Bujqësia e kontraktuar'. Ekipi ka bërë përpjekje të mëdha për validimin e rezultateve nëpërmjet triangulimit. Për shembull, në rastin e bujqësisë së kontraktuar ekipi ka intervistuar partnerët (kontraktorët) dy herë (gjatë sezonit dhe më pas) dhe një mostër të madhe të fermerëve (pas sezonit). Të gjeturat nga kontratat dhe fermerët janë shfrytëzuar gjithashtu për të validuar raportet nga secila palë. Rezultatet e të gjitha intervenimeve (ato që kanë prodhuar rezultate gjatë vitit 2018) janë validuar, analizuar dhe vlerësuar në tërësi dhe janë skontuar nga mbivendosja me qëllim që të prodhohen rezultate të besueshme dhe të atribuueshme. Gjithashtu, PPSE-ja ka atribuuar rezultatet indirekte nga dy intervenime ('Promovimi ndërkombëtar' dhe 'Sistemi i bujqësisë së kontraktuar') bazuar në standardet dhe referencat ndërkombëtare.¹³

Përveç kësaj, PPSE-je ka kryer një studim të gjerë - anketën e ofertës së turizmit, me një mostër prej 468 NVM të lidhura me turizmin në tërë Kosovën. Anketa ofertës turistike do të bëhet çdo vit, për të kuptuar fillimisht ndikimin e të ardhurave dhe punësimit në sektorin e turizmit dhe do të përdoret për të monitoruar rritjen e sektorit të turizmit, ku rezultatet e anketës së kryer në vitin 2018 do të përdoren si rezultate bazë. Gjithashtu, të gjeturat e anketës do të shfrytëzohen për të përcaktuar matësin e përafërt të punësimit (të përdorur në fazën e I-rë), bazuar në shpenzimet në turizëm, vlerësimin e ndikimit të atribuuar në punësim. Është e rëndësishme të theksohet se PPSE-ja ka menaxhuar të gjitha vlerësimet duke angazhuar anketues dhe këshilltarë (për anketën e ofertës së turizmit).

Një arritje e rëndësishme për PPSE-në në vitin 2018 ishte prezantimi i matësve të përafërt të punësimit dhe metodologjia e shumëzimit të përdorura nga PPSE-ja, nga specialisti i MRM-së në ngjarjen vjetore BEED DCED në Nairobi, Kenia.

¹³ Për ndërhyrjen e "Promovimi ndërkombëtar" ekipi ka përdorur metodologjinë PPSE-së për atribuimin e ndikimit të turizmit, ku ndikimi indirekt është llogaritur përmes shumëfishuesve të WTTC-së (këshillit botëror për udhëtim dhe turizëm). Për 'Sistemin e kontraktimit të bujqësisë', PPSE ka shfrytëzuar shumëfishuesit e FAO-s për bujqësi ekstensive dhe referencën e atribuimit të tillë në kuadër të projekteve Swisscontact (p.sh. IME dhe Katalyst).

7.3 Komunikimi

Në vitin e parë të fazës së II-të, PPSE-ja është angazhuar në komunikimet për zhvillim për të theksuar ndikimin e mbështetjes zvicerane duke përdorur shumëllojshëm kanalesh dhe media.

Ngjarjet: Në muajin janar, përkrahja përmes mediave dhe promovimit (në Kosovë dhe Zvicër) iu është ofruar shoqatës së përpunuesve të drurit të Kosovës në lidhje me pjesëmarrjen në panairin Swissbau në Basel. Në muajin mars, PPSE-ja ka organizuar ngjarjen e lansimit të fazës së II-të, e cila është zyrtarizuar nga Ambasadori zviceran në Kosovë dhe Zëvendësministri i Tregtisë dhe Industrisë, ndër të tjerë. Në muajin prill, PPSE-ja ka shënuar Ditën e Tokës me një iniciativë të komunitetit që është përqafuar nga Komuna e Prishtinës; roli i PPSE-së si iniciator është vënë re. Në muajin korrik, në bashkëpunim me PriFest është organizuar një udhëtim dy-ditor për zbulimin/evidentimin e vendeve për filmbërësit. Në muajin tetor, është organizuar një vizitë dy-ditore tek përfituesit, për SDC-në. PPSE ka mbështetur partnerët, p.sh. shoqatën ORGANIKA dhe SHTIB, për organizimin e ngjarjeve të certifikimit dhe promovimit.

Mediat sociale dhe prezenca online: PPSE-ja ka lansuar projektin për faqen e re të internetit, ndërsa faqja e PPSE-së në faqen e internetit të Swisscontact në mbarë botën është përditësuar për të pasqyruar aktivitetet e fazës së II-të.

Faqja e PPSE-së është përditësuar plotësisht në webfaqen e internetit të Swisscontact-it në të gjithë botën, për të pasqyruar aktivitetet e fazës së II-të dhe për të shfaqur rezultatet e fazës së I-rë. Faqja në Facebook e PPSE-së ishte mjeti kryesor i komunikimit online ka pasur **262,853** numër total të shtrirjes (numër të përdoruesve unikë, pëlqyes apo jo të faqes, të cilët i kanë parë postimet në faqe). Postimet tona janë shpërndarë nga faqja zyrtare e Ambasadës së Zvicrës në Facebook; Swisscontact-i mbarë botëror; grupi i partnerëve zbatues të SDC-së, si dhe faqet partnere ose individuale. Gjithashtu, PPSE-ja ka llogari në Twitter dhe një llogari në medium.com. Anëtarët e ekipit përdorin llogaritë personale të LinkedIn për të shpërndarë më tej lajmet e projektit.

Publikimet dhe videot: PPSE publikoi dy gazeta gjysmë vjetore të projektit, të cilat janë pranuar shumë mirë nga audienca; në muajin qershor, specialistja e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun u ftua nga emisioni i mëngjesit i RTK-së për të folur për konceptin e gazetës. Publikime të tjera përfshijnë: dokument një-faqesh për fazën e dytë; broshurë mbi shërbimin ekspertëve seniorë; Broshura "Takoni ciceronin tuaj lokal". Mbështetje dhe këshillim për partnerët me botimet e tyre (p.sh. broshura e komunës së Graçanicës për grumbullimin dhe riciklimin e mbeturinave) dhe njoftimet për shtyp (p.sh. CEED Kosova). PPSE ka zhvilluar një video për të nxjerrë në pah aktivitetet dhe rezultatet e [fazës së parë](#), një video mbi [një produkt të ri turistik](#) dhe një pjesë video të aktivitetit të [zbulimit/evidentimit të lokacioneve](#). Në bashkëpunim me Moments Production, PPSE po promovon prodhuesit lokal përmes emisionit televiziv "Toka Jonë" që shfaqet në Klan Kosova. Kronikat e prodhuara deri tani mund të gjenden [këtu](#).

Raportimi në media: Në periudhën raportuese, PPSE-ja dhe aktivitetet e përfituesve tanë kanë marrë mbulim të mirë të medias përmes: artikujve të botuar në agjencitë online të lajmeve rreth aktiviteve të financuara nga SDC përmes PPSE-së; radio dhe intervista televizive me anëtarët e ekipit të PPSE-së dhe përfituesit; raporte televizive mbi aktivitetet specifike të PPSE-së apo artikuj të botuar fillimisht nga PPSE dhe më pas të mbledhura nga mediat lokale. Shih Shtojcën VII për listën me citime dhe paraqitjet mediale të PPSE-së, Swisscontact-it dhe SDC-së.

Pajtueshmëria dhe dukshmëria: Të gjitha materialet e komunikimit të PPSE-së ndjekin udhëzimet e shënjimit dhe komunikimit të SDC-së. Çdo gjë botohet në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe. Ndihe më në

lidhje me marrëdhëniet me publikun dhe komunikimet iu është ofruar përfituesve të projektit dhe institucioneve partnere sipas nevojës, p.sh. iu është ofruar ndihmë për krijimin e lajmeve për media, hartimin e njoftimeve për shtyp dhe koordinimin e ngjarjeve në mënyrë që të sigurohet se janë zbatuar kërkesat që lidhen me dukshmërinë.

8. Mësimet e nxjerra

Bazuar në përvojën e kësaj periudhe raportuese, PPSE-ja ka identifikuar disa mësimet specifike të lidhura me rezultatet, të cilat do të përdoren për udhëheqjen dhe përmirësimin e zbatimit përgjatë fazës së II-të.

- Gjatë dy viteve të fundit, përfshirja e donatorëve në nën-sektorët ku PPSE-ja është përfshirë është rritur ndjeshëm, sidomos sa i përket produkteve pyjore jo-drusore. PPSE-ja ka intensifikuar koordinimin me projektet e tjera të donatorëve për të shmangur duplikimin në mbështetjen financiare për NVM-të dhe fermerët. PPSE-ja është e fokusuar në eksplorimin e mundësive për intervenime në segmente të ngushta që kanë potencial për ndryshime sistemore si dhe po kërkon mundësi për sinergji.
- Pas përvojës së fazës së I-rë të zhvillimit të produkteve të turizmit në rajonin e Pejës, ekipi priste reagim më të lartë të sektorit privat për të investuar në produktet e turizmit. Përkundër kësaj pritjeje, kishte pak interes nga sektori privat për të investuar në produktet e turizmit, veçanërisht në rajonin e Prishtinës dhe rajonin e Prizrenit. Për të adresuar këtë çështje, ekipi ka ndryshuar qasjen, duke bërë planifikime për segmentet turistike në vend që të fokusohet në destinacione, si dhe përgatitjen e thirrjeve për propozime në lidhje me zhvillimin e produktit. Megjithatë ekziston potencial i madh i sektorit privat për të investuar në turizëm, ka mungesë të njohurive dhe ekspertizës teknike. Prandaj, PPSE-ja në mënyrë aktive është duke lehtësuar shkëmbimin e njohurive në fushat e zhvillimit të produktit. Për më tepër, ekspertiza dhe njohuritë teknike janë vendimtare për projektet dhe sektorin privat, në të gjithë sektorët, kur vendoset për të investuar dhe PPSE-ja do ta shfrytëzojë atë edhe kur mbështesin NVM-të përmes fondit të mundësive.
- Përgjigja nga Komuna e Prishtinës dhe e Komuna e Prizrenit ka qenë shumë pozitive, ku disa projekte/atraksione të mëdha turistike janë në planifikim dhe zbatim. PPSE-ja ka shërbyer si lehtësues në shfrytëzimin e fondeve publike ose partneriteteve publike-private për zhvillimin e produkteve më të mëdha të turizmit dhe rezultatet pritet të shihen së shpejti.
- KIESA ka vendosur të financojë plotësisht pjesëmarrjen e Kosovës në disa panairë ndërkombëtare. Kjo paraqet një tregues të mirë të qëndrueshmërisë. PPSE-ja nuk mbështetë më NVM-të për pjesëmarrje në panairë që janë në portfolion e KIESA-s. PPSE-ja tani është më shumë e fokusuar në lehtësimin e promovimit ndërkombëtar, në të dy sektorët, qoftë drejtpërdrejt me agjencitë e eksportit ose përmes mbështetjes së BMO-ve të sektorit në panairë të veçanta pjesëmarrëse të cilat nuk janë në portfolion e KIESA-s. PPSE-ja është duke kërkuar në mënyrë aktive akterë në tregjet burimore, si bashkë-lehtësues (p.sh. Triple E) ose si partnerë, për të promovuar ofertën e turizmit në Kosovë, si dhe eksportet e Kosovës.
- PPSE-ja është duke kanalizuar intervenimet që kanë potencial për shtrirje të lartë të NVM-ve, siç janë shërbimet mbështetëse, përmes shoqatave të sektorit. Kjo mundëson dhe siguron shkallën, efikasitetin e kostos, qasjen më të mirë dhe i ndihmon shoqatat drejt anëtarësimit më të lartë dhe në këtë mënyrë qëndrueshmërisë së tyre. PPSE-ja do të koordinohet me donatorë të tjerë dhe palët e interesuara që punojnë drejt përmirësimit të qëndrueshmërisë së organizatave të sektorit (GIZ dhe Caritas-i zviceran).
- Megjithatë objektivat për përfshirjen e grave (në punësim) janë arritur, niveli i përfaqësimit të grave në pronësi dhe menaxhim të NVM-ve mbetet i pakënaqshëm. Për të rritur fuqizimin e grave, PPSE-ja ka zbatuar intervenime të shënjestruara. Në nivelin të bujqësisë, kjo është

veçanërisht e vlefshme për sektorin bimëve medicinale dhe aromatike. Për sektorin e turizmit, ekipi do të kërkojë mundësi në nën-sektorë të tjera siç është profesioni i mikpritjes dhe furnizimi me ushqim për turizmin, por do të kërkohen mundësi edhe në profesione të tjera ku përfshirja e grave mund të jetë e arritshme.

- Sa i përket Fondit për përfshirjen sociale, PPSE-ja ka zbatuar një intervenim në partneritet me shumë palë të interesuara. PPSE-ja ka mësuar se kur punon me partnerët e duhur brenda një komuniteti, si në Graçanicë me komunën, bizneset dhe përfaqësuesit e komuniteteve, procesi mund të jetë i suksesshëm dhe do të japë rezultate pozitive.